

Prishtinë, 30/11/2005
Kodi I ZRrE-s: D_06_2005

Zyra e Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/8 “Mbi Energjinë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I_02_2005 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006”;
4. Aplikacionin për tarifën e ngrohjes në sezonin 2005/2006 dorëzuar nga ana e Ndërmarrjes Komunale Publike (NKP) Standard / Njësia e Ngrohjes Qendrore (NjNQ) Termomit, Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) më datë 5 tetor 2005;
5. Aplikacionin për tarifën, të rishikuar në mbledhjen e datës 30 tetor, 2005 në mes të ZrE-s dhe NKP Standard;
6. Përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara për NKP Standard / NjNQ Termomit për sezonin e ngrohjes 2005/2006, nxjerrë nga ana e ZRrE-së me datë 22 nëntor 2005, shoqëruar nga ANNEX I “RAPORTI RREGULLATIV – Metodologjia dhe Rishqyrtimi i Çmimeve për Përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara për NKP Standard / NjNQ Termomit, për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006”;

Ka vendosur që:

1. Të aprovojë tarifën për NKP Standard / NjNQ Termomit për tërë gjashtëmuajorin e sezonit të ngrohjes 2005/2006 siq është paraqitur në tabelën “A” dhe “B” dhe llogaritja detale e paraqitur në ANNEX II i këtij vendimi “ RAPORTI RREGULLATIV – Përcaktimi i Tarifave për NKP Standard / NjNQ Termomit për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006”.
2. Tarifën e aprovuar do të publikohen nga ana e NKP Standard / NjNQ Termomit në njërin nga gazetën kombëtare dhe lokale që qarkullojnë në Kosovë, brenda (5) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ana e ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) do të përdorë të drejtave sipas ligjit, për të verifikuar të dhënat e paraqitura dhe faturat në të cilat është bazuar llogaritja e tarifave gjatë periudhës së ardhshme të ngrohjes.
4. Gjatë sezonit të ngrohjes 2005/2006 NKP Standard / NjNQ Termomit mund të paraqesë para Zyrës së Rregullatorit për Energji propozimin për ndryshime të arsyeshme të tarifave të aprovuara nga ZRrE-ja në pajtim me Udhëzimet e Përkohshme të datës I_02_2005 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006” nxjerrë me datë 10 gusht 2005.
5. NKP Standard / NjNQ Termomit ka të drejtë ankese ndaj vendimit të ZRrE-së duke dorëzuar raportin e plotë të dëshmuar brenda dhjetë (10) ditësh kalendarik pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimi të ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.

TARIFAT PËR NDËRMARRJEN KOMUNALE PUBLIKE "STANDARD" / NJËSIA E NGROHJES QENDRORE "TERMOMIT" PËR SEZONIN E NGROHJES 2005/2006

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT E PA-NJEHSUAR

NPK "STANDARD" / NjNQ "TERMOMIT"		
Komponentet e Tarifave	Amvisri	Komercial dhe Institucional
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	PA	€ 0.25 / m2 për muaj
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	PA	€ 1.05 / m2 për muaj

PA: E Pa-aplikueshme

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT E NJEHSUAR

NPK "STANDARD" / NjNQ "TERMOMIT"	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes ne kW (komponenta fikse)	PA
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta fikse)	PA

PA: E Pa-aplikueshme

Inkurajojmë Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore që të matin konsumin e ngrohjes nëpër nënstacione sa më shumë që të jetë e mundur përmes njehsorëve të kalibruar të ngrohjes, posaçërisht për konsumatorët komercialë dhe institucionet.

Në emër të ZRrE-së

Dr. Nick F. Frydas
Kryesues i Bordit